



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:244815

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625667

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.B. me vendbanim në Ferizaj, Rr.”...”, nr.... , për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1664/2021 të datës 24.01.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, më datë 14.03.2024, në të cilën kanë marrë pjesë të gjitha palët dhe atë prokurori i shtetit Sadat Topalli, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri M.B. si dhe mbrojtësi i tij me autorizim avokat Dalip Bega dhe i dëmtuari A.N., më datë 18.03.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 26.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.B. me nofkën Gj. nga babai J. dhe nëna N., e vajzërisë B., i lindur më, në Prishtinë, me vendbanim rrugën “...”, nr....., në Ferizaj, me numër personal ..., i martuar, prind i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, punon kamerier, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë në ndalim nga data 16.10.2021 ora 17:00 deri me datë 18.10.2021 ora 15:00, si dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 01.11.2021 ora 11:00 deri më datë 30.11.2021 ora 11:00.**

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 16.10.2021, rreth orës 15:15, në fshatin ..., Komuna Ferizaj, i pandehuri derisa ishte duke drejtuar automjetin “Fiat Punto”, ngjyrë të kuqe, me targa të regjistrimi 06-..., nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenet 53 pika 1 dhe 151 të Ligjit 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, në atë mënyrë deri sa ishte duke vozitur nga drejtimi i Gjilanit për në Ferizaj, me të arritur përballë depos “B.”, duke mos ju përshtatur rregullave dhe kushteve të trafikut, fillimisht duke zhvilluar shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar dhe atë me 50 km/h në rrugën ku është shpejtësia e kufizuar në 40 km/h, dhe pastaj duke mos i dhënë përparësi kalimi këmbësorit të moshuar (84 vjeçar), duke mos qenë i vëmendshëm në vendbanim, me pjesën e parë të anës së majtë e godet këmbësorin N.U. i cili ishte duke e kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë të lëvizjes së automjeti, me ç’rast këmbësori fillimisht ishte dërguar në Qendrën Emergjente në Ferizaj, e pastaj për trajtim të mëtutjeshëm në QKUK – Klinikën Intensive ku me datën 29.10.2021 ka ndërruar jetë, vdekja e të cilit është e dhunshme dhe ka ardhur si pasojë e zbutjes trunore si rrjedhojë e shembjes (dëmtimit) të trurit, pas aksidentit në trafik.

- Me këtë ka kryer veprën penale **Rrezikim i trafikut publik** nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452 paragrafi 1, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 3 (tre) viteve, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht. Në dënimin e shqiptuar të pandehurit i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga data 16.10.2021 ora 17:00 deri me datë 18.10.2021 ora 15:00, si dhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 01.11.2021 ora 11:00 deri më datë 30.11.2021 ora 11:00.

II. Refuzohet propozimi i prokurorit të shtetit që të pandehurit t’i shqiptohet dënimi plotësues – marrja e lejes së vozitjes.

III. I dëmtuari A.N. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro, për ekspertizat e komunikacionit shumën prej 1,050 (njëmijë e pesëdhjetë) euro dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, andaj obligohet i pandehuri që në total lidhur me shpenzimet e procedurës penale ta paguaj shumën prej 1,100 (një mijë e njëqind) euro, brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1664/2021 të datës 24.01.2022, ndaj të akuzuarit M.B., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Më datë 05.05.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar.

Më datë 09.11.2022, 28.03.2023, 22.05.2023, 01.06.2023, 25.10.2023, 20.02.2024 dhe 14.03.2024 janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor ku kane prezantuar prokurori i shtetit Sadat Topalli, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri M.B. dhe i dëmtuari A.N. me përfaqësuesin me autorizim të palëve të dëmtuara av. Visar Musa.

Më datë 26.06.2023, kjo lëndë penale ka kaluar nga gjyqtarja M.Sh. tek gjyqtari Dardan Maloku.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: në bazë të nenit 351 të KPP-së, paraqes fjalën përfundimtare kundër të akuzuarit M.B., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 të KPRK-së, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, dëgjimit të dëshmitarit A.N., dëgjimit të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor si dhe provave materiale siç janë ekspertiza mjekësore ligjore, si dhe ekspertiza nga ekspertet rrugorë ku gjatë shtjellimit dhe elaborimit të këtyre provave është vërtetuar se i akuzuari M.B. ka kryer veprën e cila është përshkruar në aktin akuzues të prokurorit të shtetit, andaj i propozoj gjykatës që të

njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penale të paraparë me ligj, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese dhe lehtësuese konform dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i propozoj gjykatës që të këtë parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkaktimi i pasojës, e cila pasojë është humbja e jetës së të ndjerit, ndërsa rrethana lehtësuese nuk kemi gjetur.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar A.N., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: e mbështesim në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, i propozojmë gjykatës që gjatë matjes së dënimit ti merr parasysh rrethanat, pasojën dhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale edhe pse i akuzuari nuk e ka pranuar veprën penale deri në seancën e sotme edhe pas nxjerrjes së disa ekspertizave të komunikacionit ne nuk i bashkangjitemi ndjekjes penale dhe i mbetet gjykatës të vendos nën këto rrethana, sa i përket kërkesës pasurore juridike të njëjtën e paraqesim, mirëpo nuk kemi një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike, të njëjtën do ta realizojmë në procedurë civile.

Mbrojtësi i të pandehurit av. Dalip Bega në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Aktakuza e prokurorisë e ngarkon të pandehurin se gjatë ngasjes së automjetit, ka vepruar në kundërshtim me nenet 53 pika 1 dhe 151 të ligjit 05/L-088 për rregullat e trafikut Rrugor, dhe me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke u bazuar vetëm në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit rrugor A.K. të datës 05.11.2021, i cili gjatë përpilimit të ekspertizës, nuk ka pasur të dhëna të plota lidhur me mënyrën dhe rrethanat e ndodhjes së aksidentit, dhe si rrjedhojë ka dhënë mendim dhe konstatim të gabueshëm lidhur me fajësinë për lëshimet e të pandehurit. Pas shikimit të video-incizimet, i njëjti ekspert, me datë 19.02.2023 e bënë plotësimin e ekspertizës së parë të datës (05.11.2021) me ç ‘rast ka konstatuar ndryshim rrënjësor të rrethanave të kanë kushtëzuar shkaktimin e aksidentit, e të cilat rrethana shkojnë në favor të pafajësisë së të pandehurit, dhe që për hirë të drejtësisë, të pandehurit në asnjë mënyrë nuk mund ti mveshin lëshimet primare për shkaktim të aksidentit, por eventualisht vetëm sekondare. Gjatë seancave të mbajtura dhe provave të administruara, si video-incizimi dhe sidomos pas Sqarim Plotësimit të datës 19.02.2023 të ekspertizës (së datës 05.11.2021), është vërtetuar se lëshimet e këmbësorit kanë qenë primare dhe kanë ndikuar pashmangshëm në shkaktimin e aksidentit. Eksperti i komunikacionit rrugor, në plotësimin e ekspertizës e pastaj edhe në seancën e datës 22.05.2023 deklaroi, citoj “në rastin konkret shpejtësinë e automjetit e kam përcaktuar në bazë të diagramit dhe jo në bazë të gjurmëve të frenimit”- dhe lëshimet primare në këtë aksident ia

mveshë të pandehurit, duke u bazuar vetëm në zhvillimin e pretenduar të shpejtësisë prej 70 km/h, edhe pse sipas diagramit, goditja e këmbësorit ka ndodhur me pjesën e poshtme të mbrojtësit (foto fq.3/11 fig.2, si dhe fq 8/11 fig,57) andaj rrjedhimisht shpejtësia duhet të ketë qenë në kufij 40-50 km/h, dhe në asnjë rrethanë në 70 km/h, kështu që ky konstatim do duhet vlerësuar si i pa mbështetshëm.

Andaj, konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor A.K., lidhur me shpejtësinë e lëvizjes së automjetit të pandehurit prej 70 km/h, i bazuar vetëm në një provë për të cilën (në pyetjen e prokurorit) vet eksperti deklaron se” nuk mund ta quaj as relative dhe as absolute” atëherë domosdoshmërisht duhet vlerësuar si konstatim-provë të pa mbështetshme, dhe rrjedhimisht lëshimet eventuale të pandehurit nuk mund të konsiderohen kryesore-primare, përkundrazi.

I pandehuri M.B. në fjalën tij përfundimtare deklaroi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam diçka tjetër se çfarë të shtoj.

2.Provat e administruara:

Në shqyrtim gjyqësor gjykata ka administruar provat si në vijim:

- Dëshmia e dëshmitarit – ekspertit A.K.;
- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit A.N.;
- Si dhe janë administruar provat materiale:
- Raporti i aksidentit me numër 2021-CFT-661, i datës 16.10.2021;
- Raporti i policit hetues së bashku me skicën e vendit të ngjarjes, i datës 16.10.2021;
- Deklarata e të dëmtuarit A.N. e dhënë para zyrtarve policor në fshatin ..., Komuna Ferizaj, e datës 03.11.2021;
- Deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit A.N. në Prokurorin Themelore në Ferizaj, e datës 26.11.2021;
- Deklarata e të pandehurit M.B. në Stacionin Policor në Ferizaj, i datës 16.10.2021;
- Raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm – Qendra Emergjente Ferizaj, me numër të protokollit ..., e datës 16.10.2021;
- Certifikata e vdekjes së të ndjerit N.U., me numër të rastit MA21-..., e lëshuar me datë 30.10.2021;
- Raporti i autopsisë me numër të referencës në DML: MA21-..., i datës 30.10.2021;

- Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor Msc. A.K., i datës 05.11.2021;
- Sqarimi i ekspertizës nga eksperti i komunikacionit rrugor Msc. A.K., i datës 19.02.2023;
- Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor Msc. Xh.M., i datës 15.06.2023;
- Ekspertiza e aksidentit të komunikacionit rrugor nga grupi i ekspertëve i datës 17.01.2024;
- Polisa e sigurimit me numër ...;
- Foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, 2 (dy) CD dhe 1 (një) USB si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë.

2.1. Deklarata e dëshmitarit A.N.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit A.N. në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: e kam dhënë një deklaratë në prokurori për këtë rast, qëndroj pranë deklaramit që e kam dhënë edhe pse ky deklaram është dhënë pasi që ka ndodhur rasti dhe kam qene i mërziur, mirëpo qëndroj pranë saj dhe besoj se më kujtohet se çka kam deklaruar. Prindi im ka qenë i moshës 84 vjeçare dhe ka qenë mirë me shëndet, nuk ka pasur asnjë problem shëndetësor, ditën kur ka ndodhur ky rast ka qenë ditë e shtune, ku zakonisht çdo të shtune i njëjti ka dalë në treg nga fshati ..., zakonisht ka udhëtuar me mua pasi që unë punoj në Ferizaj, por atë ditë i njëjti ka udhëtuar nga fshati ... për në Ferizaj me autobus. Atë ditë unë kam qenë me vëllain tim i cili ishte në pushim nga shteti i Danimarkës dhe pas dite jemi nisur që të shkojmë në shtëpi, por për shkak të rrugës së ngarkuar me kolonë, jemi nisur në një rrugë alternative dhe pasi kemi dalur në fshatin ... e kam parë që afër stacionit ku ndalen autobusat për fshatin ..., ka ndodhur një aksident dhe jemi ndalur dhe unë e kam pyetur një kushëri të fshatit se çka ka ndodhur, i njëjti më ka njoftuar se ka ndodhur një aksident, ai person më ka thënë se nuk e din se kush është personi që e ka shkelur vetura dhe kam dalur në trotuar ku aty kam parë një këpucë dhe një qadër të cilat i kam njohur se kanë qenë të prindit tim dhe e kam pyetur B.H. i cili është pronar i firmës “B. “i cili ndodhet përball vendit ku ka ndodhur aksidenti, por i njëjti më ka thënë se nuk është njohuri se kush është personi, unë i thash se ai person siç po shihet është prindi im, pastaj i njëjti më udhëzoi që të flas me familjen në telefon dhe ti pyet a është kthyer prindi në shtëpi dhe e kam thirr në telefon bashkëshorten time të cilën e kam pyetur se a ka ardhur aga në shtëpi, e njëjta më ka thënë jo. Ju njoftoj se në vendin e ngjarjes kanë qenë vetëm policia, ndërsa personin që

kish ndodh aksidenti e që e kuptova që ishte prindi im e derisa unë isha duke biseduar me këtë person, emergjenca e ka marr, e kam marr këpucën në vendin e ngjarjes dhe kam shkuar në shtëpi me vëllain dhe e kam pyetur bashkëshorten se a është këpuca e prindit tonë edhe pse isha i sigurt që është e tij, por nuk dëshiroja të besoja se kjo gjë i ka ndodhur prindit tim, pastaj bashkëshortja më tha se kjo këpucë është e prindit tonë, pastaj unë së bashku me vëllain jemi nisur për në emergjencën e Ferizaj ku gjate rrugës më ka telefonuar me telefonin e prindit B.P. i cili është i fshatit tonë dhe punon në Emergjencë dhe më ka njoftuar se prindi është pa vetëdije në emergjencë dhe ka kërkuar që të shkojmë, ndërsa unë i thash se jemi duke ardhur. Pastaj jemi mbërrir në emergjencë kur e kam parë prindit duke ja dhënë ndihmën e pare, pasi që ja kanë dhënë ndihmën e parë e kane nisur për në QKUK- Prishtinë ku pastaj atje është pranuar në klinikën intenzive dhe me datë 29.10.2021, rreth orës 8 apo 9 na ka thirr mjeku nga Spitali i Prishtinës që të paraqitemi në klinikë dhe pasi kemi shkuar atje na kanë njoftuar se prindi ka ndërruar jetë dhe na ka shprehur ngushëllim. Ju njoftoj se çdo ditë e kam vizituar në Klinikën Intenzive, por gjatë kohës ka qenë pa vetëdije. Ju njoftoj se familjen e të akuzuarit e kemi pranuar sipas traditave në ceremoninë e varrimit të prindit, mirëpo sa i përket rastit të ndodhur nuk ja kemi falur atë që ka ndodhur edhe pse i njëjti ka dërguar ndërmjetësues për tu pajtuar duke kërkuar falje për atë që ka ndodhur dhe kërkoj nga gjykata që sa i përket këtij rasti, i njëjti të merr vendimin e merituar për atë që e ka shkaktuar.

2.2. Deklarata e dëshmitarit – ekspertit A.K.

Eksperti A.K. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: gjatë hartimit të ekspertizës për bazë merren gjurmët e frenimit, dhe pozicioni i goditjes së këmbësorit me automjet. Konstatimin e shpejtësisë në rastin konkret e kam bërë në bazë të një diagramit i cili përdoret edhe në Institutet Evropian e cila ka të bëjë me rastet e goditjes automjet-këmbësor, ku dhe është paraqitur edhe në figurën 57 në faqen 8 të ekspertizës. Tek rasti konkret është marrë pozicioni i goditjes mes këmbësorit dhe veturës i cili goditjen e ka marrë me këndin e anës së majtë të pjesës ballore, duke u shtrirë mbi kapak të motorit dhe me kokë duke e goditur pjesën e sipërme të anës së majtë të mbrojtësit- shofershajmes. Goditja e këmbësorit ka ndodhur nga ana e majtë e veturës të pjesës ballore siç e cekam më lart, e që i bie në anën e djathtë të këmbësorit ku sipas gjatësisë së këmbësorit goditja me kokë ka ndodhur në pjesën e sipërme të anës së majtë të shofershajmes të cilat sqarime ndodhen në faqen 8 të ekspertizës figura 10 dhe foto nr.3 ku me anë të shigjetave janë shpjeguar pozicionet e goditjes. Tek rasti automjeti i përfshirë në aksident është automjet me formë pikore, pjesët e dëmtuara në anën e majtë të

automjetit kanë determinuar shpejtësinë e lëvizjes së automjetit para goditjes së këmbësorit si dhe pas goditjes. Shpejtësia e lëvizjes është dhënë mbi bazën e dokumenteve që më janë ofruar nga organet policore, ndërsa bazuar në diagram është bërë nga goditja në anën e majtë të pjesës lartë të shofershajmes dhe atë e cila është në mes të kufijve 60-80 km në orë e që shpejtësinë mesatare për këtë rast e kam marr rreth 70 km në orë. Në rastin konkret unë nuk kam pasur ndonjë provë me atë të cilës do ta vërtetoja saktë gjatësinë e këmbësorit mirëpo bazuar në pikat e goditjes në automjet në diagram kam dhënë një gjatësi të këmbësorit rreth 1.62-1.75m. Në rastin konkret shpejtësinë e kam përcaktuar në bazë të diagramit të cilin e ceka më lartë dhe jo në bazë të gjurmëve të frenimit. Bazuar në lëshimet e pjesëmarrësve në komunikacion të përcaktuara në plotësim-ekspertizën nga ana ime, pas marrjes së video incizimeve dhe analizës në hollësi të tij kam mundur të konstatoj se kontribuues në rrjedhën e aksidentit është edhe këmbësori i cili gjatë kalimit apo trupimit të rrugës nuk ka qenë i kujdesshëm, të njëjtat lëshime i kam konstatuar si lëshime sekondare për faktin se aksidenti apo goditja e këmbësorit ka ndodhur në vendbanim ku kufizimi i shpejtësisë së lejuar është 40km në orë, meqenëse këmbësori ka pasur të drejtë të kaloj rrugën andaj i kam cilësuar si lëshime sekondare apo dytësore, por i njëjti e ka pasur të ndaluar të kaloj rrugën drejtpërdrejtë para automjetit në lëvizje pa u siguruar se një veprim i tillë paraqet rrezik si fillim për veten e tij dhe për pjesëmarrësit të tjerë. Ndërsa sa i përket lëshimeve primare në këtë aksident kam konstatuar bazuar në mos respektimin e shpejtësisë së lëvizjes në atë rrugë që ka qenë 40km/h dhe atë në shpejtësi rreth 70 km/h si dhe kushteve të rrugës si dukshmëria për shkak se koha ka qenë me shi, mungesa e përqendrimit gjatë drejtimit të automjetit, mos reagimi në kohë gjatë lëvizjes për ndalje. Ka metoda të ndryshme lidhur me përcaktimin e shpejtësisë së lëvizjes siç janë metoda për përcaktimin e shpejtësisë përmes gjurmëve të frenimit si dhe metoda përmes diagramit, ku në rastin konkret unë shpejtësinë e lëvizjes e kam përcaktuar në bazë të metodës së diagramit e cila bazuar në gjurmët e frenimit ka qenë e përafërt, ku pika goditëse në këtë rast është brenda gjurme të frenimit. Determinuese ka qenë shpejtësia e lëvizjes për shkaktimin e pasojës. Këtë analizë e kam bërë sipas Softuerin aplikativ virtual crash dhe kam konstatuar se për shpejtësi të deklaruar të lëvizjes aksidentit nuk do të kishte ndodhur me një frenim të vrullshëm në distance prej 12.2m ka mundur të ndalet. Po kam dalur në vendin e ngjarjes dhe atë dy herë me qëllim të mbledhjes së fakteve lidhur me këtë çështje për dhënien e mendimit më korrekt, ku në të dy anët e rrugës është kryqëzimi i rrugës kryesore me atë dytësore, gjithashtu gjendet një depo e cila quhet B. si dhe ka institucion shkollor rreth 300-400m ku ka ndodhur aksidenti.

3. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: Me datë 16.10.2021, rreth orës 15:10- 15:20 kam qenë duke ardhur me veturën time “Fiat Punto” nga drejtimi i Gjilanit në drejtim të Ferizaj dhe në fshatin ..., deri sa kam qenë duke vozitur në trason – anën time, shpejtësia e lëvizjes së lejuar ka qenë 40 km në orë, ndërsa unë kam qenë dikund 40-50 km në orë dhe një automjet pikap apo kombi nuk më kujtohet ka qenë i ndalur në anën e majtë të rrugës, paralel me mua dhe në moment tani i ndjeri ka dalur mbrapa atij automjeti dhe ka dalur në rrugë para meje dhe unë nuk kam pasur hapësirë, kohë për me kqyr – me u shmang dhe në atë moment i ndjeri ka qenë duke vrapuar dhe unë jam munduar me u kthyer në anën e djathtë dhe aty e kam goditur këmbësorin me anën e majtë të veturës time dhe në atë moment unë jam ndalur dhe e kam thirrur policinë, ambulancën dhe kam qëndruar aty te i ndjeri deri sa ka ardhur ekipi mjekësor, pastaj ka ardhur policia dhe në ato momente më ka larguar policia nga vendi i ngjarjes pasi që nuk e dinin që unë jam shkaktar dhe ju kam thënë që unë jam shkaktari që e kam shkaktuar aksidentin dhe ata me murrën dhe vazhduam në stacion policor. Pasi kam dalur prej qendrës së paraburgimit, babai im dhe vëllai im i kanë bërë kërkesë familjes së të dëmtuarit për të shkuar në spital në Prishtinë për me vizituar dhe familja nuk na kanë pranuar dhe të njëjtit kanë thënë se janë duke u mirrur me gjendjen e babait të tij, dua të shtoj se babai ime dhe tre djemtë të xhaxhallarëve dhe dy dajtë e mi kanë qenë në varrimin e të ndjerit dhe pastaj kemi dërguar shumë njerëz për me i kërkuar falje dhe me u pajtuar dhe të njëjtit nuk kanë dashur që të pajtohem. Në rrugë ka pasur edhe automjete të tjera në anën e kundërt, që kanë lëvizur ngadalë, por kombi që e theksova ka qenë pothuajse i ndalur dhe ka qenë po quaj një lloj kolone sepse veturat kane hecur ngadalë, prej momentit kur e kam parë personin i njëjti ka qenë larg nga automjeti im 1 apo 2 metra, nuk më kujtohet sepse edhe sot nuk e ndjeje veten mirë. Në vendin ku ka ndodhur aksidenti ka qenë vendbanim dhe shkolla ka qenë larg rreth 100 metra, stacion ku zbresin këmbësorët nuk ka, mirëpo në vendin ku ka ndodhur aksidenti, nuk zbresin këmbësorët, mirëpo stacioni i këmbësorëve është 50 metra më larg. Për fund dua të shtoj se bazuar në shpejtësinë 50 km në orë, që është shënuar në ekspertizën e fundit unë e pranoj fajësinë, mirëpo nëse mbetët ashtu siç është shënuar në aktakuzë 70 km në orë, nuk e pranoj fajësinë, dhe prape dua të deklarojem se me vjen keq për rastin që ka ndodhur dhe i shprehi prapë ngushëllime familjarëve.

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç ‘rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata ia fali besimin dëshmisë së dëshmitarit – ekspertit A.K. dhe nga e njëjta gjeti se aksidenti është shkaktuar me lëshimet primare të ngasësit të automjetit “A” M.B. i cili ka qenë duke drejtuar automjetin Fiat Punto dhe me lëshimet e këmbësorit N.U. të cilat konsiderohen si lëshime dytësore (sekondare).

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit – dëshmitarit A.N. dhe nga e njëjta gjeti se tani i ndjeri N.U. ka qenë me gjendje të mirë shëndetësore dhe se ditën kritike dëshmitari A.N. e ka parë që afër stacionit ku ndalen autobusat për fshatin ..., ka ndodhur një aksident dhe një kushëri e ka njoftuar se ka ndodhur një aksident, por fillimisht nuk e ka ditur se bëhet fjalë për babain e tij. Pastaj i njëjti së bashku me vëllain e tij jemi nisur për në emergjencën e Ferizaj ku gjate rrugës e ka telefonuar me telefonin e prindit B.P. i cili punon në Emergjencë dhe e ka njoftuar se prindi është pa vetëdije në emergjencë. Pasi që ja kanë dhënë ndihmën e parë tani të ndjerit e kanë nisur për në QKUK- Prishtinë ku pastaj atje është pranuar në klinikën intenzive dhe me datë 29.10.2021, rreth orës 8 apo 9, dëshmitarin A.N. e ka thirr mjeku nga Spitali i Prishtinës që të paraqitet në klinikë dhe pasi kemi shkuar atje na kanë njoftuar se prindi ka ndërëuar jetë. Familja e të akuzuarit ka marrë pjesë në ceremoninë e varrimit.

Gjykata ia fali besimin mbrojtjes së të akuzuarit të dhënë në shqyrtim gjyqësor ku i njëjti ka deklaruar se bazuar në shpejtësinë 50 km në orë, që është shënuar në ekspertizën e fundit unë e pranoj fajësinë, mirëpo nëse mbetet ashtu siç është shënuar në aktakuzë 70 km në orë, nuk e pranoj fajësinë. Nga deklarimi i të pandehurit gjykata ka gjetur se i njëjti nuk e ka mohuar

veprimin e kryerjes së veprës penale se ai është shkaktari i aksidentit mirëpo arsyeja e vetme pse i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë ka qenë se në aktakuzë është shënuar se shpejtësia e lëvizjes ka qenë 70 km/h, kurse i pandehuri ka pretenduar se ka qenë 50 km/h e që një gjë e tillë është vërtetuar nga grupi i ekspertëve.

Nga Raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm – Qendra Emergjente Ferizaj, me numër të protokollit ..., e datës 16.10.2021 gjykata gjeti se tani i ndjeri N.H. është dërguar në Spitalin e Përgjithshëm – Qendra Emergjente në Ferizaj, për shkak të lëndimeve si pasojë e aksidentit në trafik.

Nga Certifikata e vdekjes së të ndjerit N.U., me numër të rastit MA21-..., e lëshuar me datë 30.10.2021, gjykata gjeti se i njëjti ka ndërruar jetë me datë 29.10.2021.

Gjykata ia fali besimin e plotë Raportit të autopsisë me numër të referencës në DML: MA21-..., i datës 30.10.2021 dhe nga i njëjti gjeti se N.U. i lindur me datë ..., ka ndërruar jetë dhunshëm si pasojë e zbutjes trunore si rrjedhojë e shembjes (dëmtimit) të trurit, pas aksidentit në trafik.

Gjykata pjesërisht ia fali besimin Mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit rrugor Msc. A.K., i datës 05.11.2021 dhe Sqarimit të ekspertizës nga eksperti i komunikacionit rrugor Msc. A.K., i datës 19.02.2023 dhe nga të njëjtat gjykata gjeti se aksidenti është shkaktuar me lëshimet primare të ngasësit të automjetit “A” M.B. i cili ka qenë duke drejtuar automjetin Fiat Punto dhe me lëshimet e këmbësorit N.U. të cilat konsiderohen si lëshime dytësore (sekondare), ndërsa nuk ia fali besimin pjesës ku përshkruhet se automjeti ka qenë duke lëvizur me shpejtësi 70 km/h sepse nuk është paraqitur një arsyetim bindës se si ka ardhur deri tek një konstatim i tillë.

Gjykata pjesërisht ia fali besimin Mendimit dhe konstatimit të ekspertit të komunikacionit rrugor Msc. Xh.M., i datës 15.06.2023, dhe nga i njëjti gjykata gjeti se deri te aksidenti ka ardhur nga lëshimi i dy pjesëmarrësve në komunikacion dhe atë shoferi i njësisë “A” gjatë lëvizjes në atë pjesë të rrugës nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në raport dhe me kushtet e rrugës si dhe situatën e krijuar në atë pjesë të rrugës, ka zhvilluar shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar; shoferi i njësisë “A” ka pasur fushëpamje të zvogëluar, ku është dashur të ketë kujdes të shtuar; shoferi i njësisë “A” me të vërejtur këmbësorin është dashur të fillojë frenimin menjëherë; këmbësori ka filluar trupimin e rrugës pa u siguruar se është vërejtur

nga ana e shoferit të njësisë “A”; këmbësori ka filluar trupimin e rrugës pas një automjeti (drejtimi Ferizaj – Gjilan) gjë që shoferi i njësisë “A” nuk ka mundur që ta vërejë këmbësorin; këmbësori me të vërejtur njësinë “A” fillon shpejtimin e ecjes në vend se të ndalet. Ndërsa nuk ia fali besimin pjesës ku theksohet se aksidenti ka ardhur nga lëshimi i dy pjesëmarrësve në komunikacion pa e specifikuar se kush i ka shkaktuar lëshimet primare e kush sekondare e në rast se ka vlerësuar se lëshimet kanë pasur peshë të barabartë është dashur ta theksoj shprehimisht një gjë të tillë.

Gjykata ia fali besimin e plotë ekspertizës së aksidentit të komunikacionit rrugor nga grupi i ekspertëve i datës 17.01.2024 nga e cila gjeti se deri te aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur me lëshimet e bëra nga ana e drejtuesit të automjetit “A” dhe këmbësorit “B”, ku lëshimet primare janë të drejtuesit të automjetit “A” Fiat Punto dhe atë a) mospërshtatja e shpejtësisë së lëvizjes ndaj kushteve ekzistuese në rrugë (kushteve të trafikut dhe atmosferike); b) ka tejkalluar shpejtësinë e lëvizjes, ashtu që në pjesën e rrugës ku shpejtësia maksimale është e lejuar 40 km/h, ka drejtuar automjetin me shpejtësi 50 km/h dhe c) ka reaguar me vonesë në ndërmarrjen e veprimit të frenimit të vrullshëm. Kurse lëshimet sekondare janë të këmbësorit “B” N.U. dhe atë këmbësori N.U. gjatë kalimit të rrugës nuk është kujdesur sa duhet se mund të përfundojë veprimin e tij në mënyrë të sigurtë.

Nga Polisa e sigurimit me numër 0007843084 gjykata gjeti se automjeti Fiat Punto 60 me targa 06-... ishte i siguruar për periudhën kohore nga data 12.05.2021 deri më 12.05.2022.

Nga Foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes si dhe video incizimet gjykata konstatoi pamjet nga vendi i ngjarjes.

5.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Me datë 16.10.2021, rreth orës 15:15, në fshatin ..., Komuna Ferizaj, i pandehuri M.B. derisa ishte duke drejtuar automjetin “Fiat Punto”, ngjyrë të kuqe, me targa të regjistrimi 06-..., nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenet 53 pika 1 dhe 151 të Ligjit 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, në atë mënyrë deri sa ishte duke vozitur nga drejtimi i Gjilanit për në Ferizaj, me të arritur përballë depos “B.”, duke mos ju përshtatur rregullave dhe kushteve të trafikut, fillimisht duke zhvilluar shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar dhe atë me 50 km/h në rrugën ku është shpejtësia e kufizuar në 40 km/h, dhe pastaj duke

mos i dhënë përparësi kalimi këmbësorit të moshuar (84 vjeçar), duke mos qenë i vëmendshëm në vendbanim, me pjesën e parë të anës së majtë e godet këmbësorin N.U. i cili ishte duke kaluar rrugën nga ana e majtë në anën e djathtë të lëvizjes së automjeti, me ç'rast këmbësori fillimisht ishte dërguar në Qendrën Emergjente në Ferizaj, e pastaj për trajtim të mëtutjeshëm në QKUK – Klinikën Intensive ku me datën 29.10.2021 ka ndërruar jetë, vdekja e të cilit është e dhunshme dhe ka ardhur si pasojë e zbutjes trunore si rrjedhojë e shembjes (dëmtimit) të trurit, pas aksidentit në trafik.

Gjykata ka bërë ndryshimin e përshkrimit faktik që është paraqitur në aktakuzë dhe atë vetëm tek pjesa e shpejtësisë së lëvizjes e automjetit “Fiat Punto”, ngjyrë të kuqe, me targa të regjistrimi 06-... të cilin po e ngiste i pandehuri, ku në aktakuzë është theksuar se “...fillimisht duke zhvilluar shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar dhe atë me 70 km/h në rrugën ku është shpejtësia e kufizuar në 40 km/h...”, mirëpo duke u bazuar në ekspertizën e aksidentit të komunikacionit rrugor nga grupi i ekspertëve i datës 17.01.2024 e cila ka konstatuar se i pandehuri ka qenë duke zhvilluar shpejtësi 50 km/h, gjykata pasi ja fali besimin e plotë ekspertizës së lartcekur, e riformuloi përshkrimin faktik si në vijim “...fillimisht duke zhvilluar shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar dhe atë me 50 km/h në rrugën ku është shpejtësia e kufizuar në 40 km/h...”.

Neni 370 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”, si dhe paragrafi 9 i po të njëjtit nen përcakton se: “Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”. Veprimi i kryerjes së veprës penale është mospërfillja e dispozitave të trafikut, gjë që nënkupton sjellje - veprime të tilla të pjesëmarrësit në trafik me të cilat ai cenon dispozitat që rregullojnë trafikun rrugor, e në rastin që është objekt i kësaj çështjeje penale i pandehuri M.B. i ka konsumuar elementet e veprës penale që i vihet në barrë sepse a) nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes ndaj kushteve ekzistuese në rrugë (kushteve të trafikut dhe atmosferike); b) ka tejkaluar shpejtësinë e lëvizjes, ashtu që në pjesën e rrugës ku shpejtësia maksimale është e lejuar 40 km/h, ka drejtuar automjetin me shpejtësi 50 km/h dhe c) ka reaguar me vonesë në ndërmarrjen e veprimit të frenimit të vrullshëm.

Nga të gjitha të lartcekurat u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari M.B., ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me kusht në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 3 (tre) vite, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penal, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit për faktin se është hera e parë që kryen veprë penale, bashkëpunimi e përgjithshëm të pandehurit me gjykatën – organet e drejtësisë ku i njëjti pas aksidentit e ka thirrur policinë dhe ka qëndruar në vendin e ngjarjes deri sa ka shkuar aty policia dhe e ka larguar nga vendi i ngjarjes, keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri – i njëjti disa herë gjatë seancave gjyqësore ka kërkuar falje publike, sjelljen e të pandehurit pas aksidentit ku edhe familja e të njëjtit ka marrë pjesë në varrimin e tani të ndjerit sipas ceremonive – traditave, faktin se i njëjti është mbajtës i familjes – baba i një fëmije si dhe faktin se aksidenti nuk është shkaktuar vetëm me lëshimet e të pandehurit gjithmonë duke pasur parasysh se aksidenti është shkaktuar me lëshimet primare të tij, kurse rrethanë rënduese gjeti moshën e viktimës.

Qëllimi i drejtpërdrejt i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi ndaj kryesit penalisht të përgjegjshëm në rastet kur mbrojtja juridike-penale mund të realizohet edhe në mënyrë tjetër – duke e qortuar kryesin dhe duke e njoftuar se do të ekzekutohet dënimi i caktuar nëse kryen veprë tjetër penale. Njëherit ky lloj dënimi u shqiptohet vetëm atyre kryesve për të cilët gjykata formon bindje se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprë penale. Ky lloj i dënimit është në pajtim me parimin e legjitimitetit të sanksioneve penale i cili konsiston në faktin se ndaj kryesve të veprave penale duhet të shqiptohen vetëm ato lloje të dënimeve të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe arritjen e përmirësimit dhe të risocializimit. Në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë veprë penale.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Neni 79 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: *“Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë”*. Andaj, gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në dënimin e shqiptuar të pandehurit M.B. i është llogaritur edhe koha e kaluar në ndalim nga data 16.10.2021 ora 17:00 deri me datë 18.10.2021 ora 15:00, si dhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 01.11.2021 ora 11:00 deri më datë 30.11.2021 ora 11:00.

7.Vendimi mbi refuzimin e propozimit për shqiptimin e dënimit plotësues – marrja e lejes së vozitjes

Neni 65 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: *“Kryesit të veprës penale që e rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t’ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe mund t’ia ndalojë kryesit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Nëse kryesi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryesit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit prej një (1) deri në pesë (5) vjet”*, kurse paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton se *“Gjykata mund të shqiptojë dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni nëse kryesi ka kryer vepër penale duke shkaktuar lëndim të rëndë trupor apo vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit”*. Andaj, duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur gjykata refuzoi propozimin e prokurorit të shtetit për shqiptimin e dënimit plotësues – marrja e lejes së vozitjes, sepse prokuroria nuk ka paraqitur ndonjë provë me anë të së cilës do të dëshmonte se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit. Po ashtu në asnjërën nga ekspertizat nuk është theksuar një fakt i tillë.

8.Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”*. Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko – civil.

9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimin në shumën prej 20 (njëzet) Euro.

Nga formulari për kompensimin i shpenzimeve të ekspertëve, përkthyesve, vlerësuesve gjyqësor dhe profesionistëve tjerë i datës 19.02.2023 përcaktohen shpenzimet lidhur me ekspertizën e komunikacionit në vlerë prej 100 (njëqind) euro, andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguajë shumën në vlerë prej 100 (njëqind) euro.

Nga formulari për kompensimin i shpenzimeve të ekspertëve, përkthyesve, vlerësuesve gjyqësor dhe profesionistëve tjerë i datës 22.05.2023 përcaktohen shpenzimet lidhur me pjesëmarrjen në seancë të ekspertit të komunikacionit në vlerë prej 50 (pesëdhjetë) euro, andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguajë shumën në vlerë prej 50 (pesëdhjetë) euro.

Nga formulari për kompensimin i shpenzimeve të ekspertëve, përkthyesve, vlerësuesve gjyqësor dhe profesionistëve tjerë i datës 15.06.2023 përcaktohen shpenzimet lidhur me

ekspertizën e komunikacionit në vlerë prej 300 (treqind) euro, andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguajë shumën në vlerë prej 300 (treqind) euro.

Nga formulari për kompensimin i shpenzimeve të ekspertëve, përkthyesve, vlerësuesve gjyqësor dhe profesionistëve tjerë i datës 17.01.2024 përcaktohen shpenzimet lidhur me ekspertizën e komunikacionit nga grupi i ekspertëve në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro, andaj është detyruar i pandehuri që lidhur me këtë ekspertizë të paguajë shumën në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro.

Andaj është obliguar i pandehuri që në total lidhur me shpenzimet e procedurës penale ta paguaj shumën prej 1,100 (një mijë e njëqind) euro, brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2022:013981 me datë 26.04.2024

Zyrtarja ligjor,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.